



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 55

Tiranë – E premte, 31 mars 2023

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 22/2023, datë 23.3.2023            | Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar”..... 6381                                                                                                                                                               |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 23/2023, datë 23.3.2023            | Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7/2017, ‘Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme’” ..... 6381                                                                                                                                                |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 24/2023 datë 23.3.2023             | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ..... 6381                                                                                    |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 180, datë 29.3.2023 | Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s “ <i>Aegean Sea</i> ”, në detin Egje..... 6384                                                                                                                                                          |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 181, datë 29.3.2023 | Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin e koalicionit <i>FOB UNION III</i> , në operacionin e NATO-s në IRAK (NMI)..... 6385                                                                                                                                 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 182, datë 29.3.2023 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW <i>Frankfurt am Main</i> (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta..... 6385 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 183, datë 29.3.2023 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW <i>Frankfurt am Main</i> (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve..... 6391                            |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 184, datë 29.3.2023 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW <i>Frankfurt am Main</i> (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta..... 6397        |

|                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 185, datë 29.3.2023                                                            | Për miratimin e rregullave të hollësishme për të dhënat parësore dhe<br>dytësore, rregullat për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave<br>shtetërore dhe nivelin e aksesimit në regjistrin elektronik të gjendjes<br>gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, por me banim të<br>përhershëm në shtetin shqiptar..... | 6403 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 186, datë 29.3.2023                                                            | Për një ndryshim në vendimin nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të<br>Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të<br>paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi<br>Universitetit të Tiranës”, të ndryshuar.....                                                                | 6405 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural nr. 6, datë 23.3.2023                                         | Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët<br>në ushqim.....                                                                                                                                                                                                                                        | 6407 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural nr. 7, datë 23.3.2023                                         | Rregullat për hartimin, përmbajtjen e planeve të kontrolleve zyrtare,<br>për sa u përket kontaminantëve në ushqim.....                                                                                                                                                                                                           | 6409 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural nr. 8, datë 23.3.2023                                         | Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 11, datë 10.5.2021,<br>“Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, fara<br>të freskëta dhe/ose të përpunuara”.....                                                                                                                                         | 6414 |
| Urdhër i ministrit të Kulturës<br>nr. 211, datë 28.3.2023                                                              | Për delegim kompetencash.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 6495 |
| Urdhër i Komisionerit për të<br>Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen<br>e të Dhënave Personale<br>nr. 50, datë 28.3.2023 | Për delegim të kompetencave.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 6495 |

**VENDIM  
Nr. 22/2023****PËR MOSMIRATIMIN E  
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA  
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN  
NR. 43/2015, ‘PËR SEKTORIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE’,  
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar”, nismë e deputetit Petrit Vasili.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.3.2023.

**VENDIM  
Nr. 23/2023****PËR MOSMIRATIMIN E  
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA  
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN  
NR. 7/2017, ‘PËR NXITJEN E  
PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA  
BURIMET E RINOVUESHME”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7/2017, ‘Për nxitjen e

përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”, nismë e deputetit Petrit Vasili.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.3.2023.

**VENDIM  
Nr. 24/2023****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN E KUVENDIT  
NR. 86/2018, “PËR MIRATIMIN E  
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE  
KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË  
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 86/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ndryshohet sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 23.3.2023.



Lidhja nr. 1





Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS SË ZYRËS SË  
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE**

| <b>Funksioni</b>                                                                          | <b>Nr. i punonjësve</b> | <b>Kategoria/klasa</b>                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|----------------------------------------------------|
| <b>I. Komisioneri</b>                                                                     | <b>1</b>                | I-D Ligji nr. 9584, datë 17.7.2006,<br>i ndryshuar |
| <b>II. Kabineti</b>                                                                       | <b>(3)</b>              | VKM 187, datë 8.3.2017,<br>i ndryshuar             |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-a                                               |
| Këshilltar                                                                                | 1                       | II-b                                               |
| Zëdhënës                                                                                  | 1                       | II-b                                               |
| <b>III. Sekretar i Përgjithshëm</b>                                                       | <b>1</b>                | I-b                                                |
| <b>IV. Njësia e Auditit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>                          |                         | <b>(2)</b>                                         |
| Inspektor                                                                                 | 2                       | III-a                                              |
| <b>V. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit</b>                            |                         | <b>(15)</b>                                        |
| Drejtor i përgjithshëm                                                                    | 1                       | II-a                                               |
| <b>V/I. Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës</b>                        |                         |                                                    |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| Inspektor                                                                                 | 5                       | III-a                                              |
| <b>V/II. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave</b>                                           |                         |                                                    |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| Inspektor                                                                                 | 5                       | III-a                                              |
| <b>V/III. Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik</b>                       |                         |                                                    |
| Inspektor                                                                                 | 2                       | III-a                                              |
| <b>VI. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>                  |                         | <b>(20)</b>                                        |
| Drejtor i përgjithshëm                                                                    | 1                       | II-a                                               |
| <b>VI/I. Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit</b>                                        |                         |                                                    |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| Inspektor                                                                                 | 6                       | III-a                                              |
| <b>VI/II. Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave</b>                    |                         |                                                    |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| Inspektor                                                                                 | 6                       | III-a                                              |
| <b>VI/III. Drejtoria e Mbikëqyrjes në fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike</b> |                         |                                                    |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| Inspektor                                                                                 | 4                       | III-a                                              |
| <b>VII. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit</b>                               |                         | <b>(7)</b>                                         |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| <b>VII/I Sektori Rregullator, Integritetit dhe Procedurave Administrative</b>             |                         |                                                    |
| Shef sektori                                                                              | 1                       | III-a                                              |
| Inspektorë                                                                                | 2                       | III-a                                              |
| <b>VII/II Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë</b>                            |                         |                                                    |
| Shef sektori                                                                              | 1                       | III-a                                              |
| Specialistë                                                                               | 2                       | III-b                                              |
| <b>VIII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës</b>                             |                         | <b>(11)</b>                                        |
| Drejtor                                                                                   | 1                       | II-b                                               |
| <b>VIII/I. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun</b>                 |                         |                                                    |
| Shef sektori                                                                              | 1                       | III-a                                              |
| Specialist IT                                                                             | 1                       | III-b                                              |
| Specialist për burimet njerëzore                                                          | 1                       | III-b                                              |
| Specialist për marrëdhënieve me publikun                                                  | 1                       | III-b                                              |
| Nëpunës informacioni                                                                      | 1                       | Kl. II (VKM nr. 234, datë 20.4.2022)               |
| <b>VIII/II. Sektori i Shërbimeve dhe Financës</b>                                         |                         |                                                    |
| Shef sektori                                                                              | 1                       | III-a                                              |
| Specialist financë-buxhet                                                                 | 1                       | III-b                                              |
| Specialist redaktor/protokolli/arkivi                                                     | 1                       | IV-a                                               |
| Magaziner/shofer                                                                          | 1                       | Kl. V (VKM nr. 234, datë 20.4.2022)                |
| Punonjës pastrimi                                                                         | 1                       | Kl. I (VKM nr. 234, datë 20.4.2022)                |

Gjithsej

60 punonjës



## VENDIM

Nr.180, datë 29.3.2023

**PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT  
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
OPERACIONIN E NATO-S “*AEGEAN  
SEA*”, NË DETIN EGJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI

1. Dërgimin e 1 (një) anijeje të klasit “Iliria”, e kompletuar me efektivë, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s, në detin Egje (*Aegean Sea Nato Activity*), pjesë e operacionit “*Sea Guardian*”, në detin Egje.

2. Misioni i anijes është kryerja e detyrave të patrullimit, zbulimit detar, dhënies së ndihmës, njohjes së situatës detare, identifikimit, verifikimit, ndalimit të objekteve detare, në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group-2* (SNMG2), në detin Egje, në kuadër të operacionit të NATOS-s, “*Sea Guardian*”, në detin Egje.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në operacion kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e operacionit.

4. Kohëzgjatja e këtij operacioni është deri në 6 (gjashtë) muaj, me rotacion çdo 90 (nëntëdhjetë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së anijes dhe kontingjentit të parë për në operacion.

5. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) sigurimin e anijes;

d) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

dh) mbështetje shëndetësore;

e) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

ë) karburant, lubrifikante;

f) transport personeli për në zonën e operacionit;

g) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së operacionit;

gj) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

h) taksa portuale, shërbime portuale dhe të kalimit nëpër ngushtica;

i) mirëmbajtje teknike dhe riparime të anijes të paparashikuara;

j) riparim të nivelit të tretë pas kthimit nga operacioni;

k) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit të anijes që merr pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur të operacionit për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër merr përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023, në programin “Forca e luftimit”.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 181, datë 29.3.2023****PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT  
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
SHTABIN E KOALICIONIT *FOB UNION*  
*III*, NË OPERACIONIN E NATO-s NË  
IRAK (NMI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dërgimin e 2 (dy) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin e koalicionit *FOB UNION III*, në operacionin e NATO-s në Irak (NMI), në Bagdad, Irak.

2. Misioni i ushtarakëve është këshillimi i institucioneve të sigurisë së Irakut, në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, analizimin e trajnimeve të nevojshme dhe identifikimi i mangësive, si pjesë e mësimave të nxjerra.

3. Kohëzgjatja e këtij operacioni është deri në 3 (tre) vjet, afat i cili llogaritet nga data e dërgimit të ushtarakëve të parë në operacion. Periudha e qëndrimit është me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) energji elektrike, ujë dhe ujë i pijshëm;

e) transport;

ë) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së operacionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Transporti i personelit që merr pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër përballimin e këtyre shpenzimeve.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 182, datë 29.3.2023****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË  
GRANTIT PËR MASAT SHOQËRUESE,  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË (MARRËSI),  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCave DHE EKONOMISË, DHE  
KfW *FRANKFURT AM MAIN* (KfW), PËR  
PROGRAMIN PËR MENAXHIM TË  
QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME  
KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE  
TË NGURTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me



propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW, *Frankfurt am Main* (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

#### MARRËVESHJE GRANTI PËR MASAT SHOQËRUESE

E DATËS 29.12.2022 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“MARRËSI”), TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR SHUMËN 5,000,000.00 EURO

- Programi për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta -  
BMZ-No. 2018 70 344

#### Përmbajtja

##### Neni

1. Shuma dhe qëllimi i grantit
  2. Disbursimi
  3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja
  4. Kostot dhe detyrimet publike
  5. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit
  6. Shërbimet e ekspertëve
  7. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me shërbimet e ekspertëve
  8. Dispozita të ndryshme
- Zotimet e përputhshmërisë

Në bazë të marrëveshjes së datës 27 janar 2021 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (“Marrëveshja e Qeverisë”), Marrësi dhe KfW-ja

lidhin marrëveshjen e mëposhtme të grantit (“Marrëveshja e Grantit” ose “Marrëveshja”).

Kjo Marrëveshje Granti është pjesë e Programit për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta (“Programi”).

Zbatimi i Programit do të financohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Granti, një huaje që do të sigurohet në bazë të një marrëveshjeje huaje (“Marrëveshja e Huas”), një marrëveshjeje granti për një grant investimi (“Marrëveshja e Grantit për Investimin”) dhe një granti sipas një marrëveshjeje granti të financuar nga SECO (“Marrëveshja e Grantit SECO”), të gjitha të së njëjtës ose rreth datës së kësaj marrëveshjeje.

#### 1. Shuma dhe qëllimi i grantit

1.1 KfW-ja do t'i japë Marrësit një grant që nuk tejkalon shumën prej

5.000.000,00 euro (me fjalë: pesë milionë euro) (“Granti”).

Ky Grant nuk do të jetë i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi do të përdorë Grantin vetëm për shërbime konsulence për masat shoqëruese të Programit për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta (“Shërbimet e Ekspertëve”) dhe kryesisht për të mbuluar kostot e shkëmbimeve me jashtë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”), nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (“Njësia e Koordinimit të Programit” ose “NJKP”) do të veprojë si njësi e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin e përgjithshëm të projektit dhe zbatimin e Programit.

Detajet dhe objekti i Shërbimeve të Ekspertëve që do të financohen nga Granti përcaktohen nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë nga NJKP-ja dhe KfW-ja, e cila gjithashtu do të nënshkruhet si e lexuar dhe e rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrëveshja e Veçantë”).

1.3 NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë në detaje kontributet homologe që do të jepen nga Marrësi në Marrëveshjen e Veçantë, e cila gjithashtu do të nënshkruhet si e lexuar nga Marrësi. Marrësi do të japë kontributet e tij homologe plotësisht dhe në kohën e duhur. Marrësi, që vepron nëpërmjet NJKP-së, do t'i japë





KfW-së, sipas kërkesës, prova që vërtetojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të paguhet nga Marrësi, si edhe tarifat e importit nuk do të financohen nga Granti.

## **2. Disbursimi**

KfW-ja do të disbursojë Grantin në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të Marrësit. Nëpërmjet Marrëveshjes së Veçantë, e cila do të nënshkruhet si e lexuar dhe e rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. NJKP-së, dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 shtator 2028.

### **3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja**

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre,

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Granti, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit SECO, Marrëveshjes së Grantit për Investimin ose sipas marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë Marrëveshjeje Granti ose marrëveshjet e sipërpërmendura

c) Marrësi, nuk mund të provojë se shumata e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar,

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadër të kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm,

e) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve; ose

f) Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Grantit për Investimin ose Marrëveshja e Grantit SECO nuk kanë hyrë në fuqi ose ka ndodhur një rast i cili lejon KfW-në që të pezullojë disbursimet në përputhje me marrëveshjet e lartpërmendura.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 3.1/b, “c” ose “d” dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

g) në rastet e parashikuara në nenin 3.1/b ose “d” të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

h) në rastet e përcaktuara në nenin 3.1/c, të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave kur Marrësi, nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

## **4. Kostot dhe detyrimet publike**

Marrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Grantit.

## **5. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit**

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij do të përfaqësojnë Marrësin në të gjitha veprimet që kërkohen për zbatimin e Marrëveshjes së Grantit. Tagri i përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të shprehur nga përfaqësuesi i Marrësit i autorizuar në atë kohë.

5.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuale në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklarata e tillë konsiderohet e marrë menjëherë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuale përkatëse, ose në adresë të tjera të palës kontraktuale përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuale:

### **Për KfW-në:**

KfWPostfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Republika Federale e Gjermanisë  
Fax: +49 69 7431-2944

### **Për Marrësin:**

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3  
Tiranë



## 6. Shërbimet e Ekspertëve

### 6.1 Nëpërmjet NJKP-së, Marrësi

a) do të përgatisë dhe kryejë Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e rënë dakord ndërmjet NJKP-së dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve, dhe për këtë qëllim do të përdorë shërbimet e inxhinierëve konsultues të pavarur dhe të kualifikuar;

b) do të pajtohet në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) do të sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe do t'i vërë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga ky Grant;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e Shërbimeve të Ekspertëve dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga Granti financiar;

e) do t'i mundësojë në çdo kohë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë ato libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

f) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe të dhënat që lidhen me Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

g) do të informojë KfW-në, me nismën e saj për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertëve ose qëllimin e tyre.

6.2 NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet lidhur me nenin 6.1 në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet gjithashtu si e lexuar nga Ministria e Financave.

## 7. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me shërbimet e ekspertëve

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (Pas Projektit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe financimin e tyre gjatë

negociatave para-kontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Shërbimet e Ekspertëve dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/en>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 7.3 më poshtë për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit, nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tij, të tillë si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

7.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit e Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë seksione të lidhura me qëllimin:



a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës së Transparencës të Ndhmës Ndërkombëtare

(<https://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/internationale-transparenzstandards-59280>)

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI). për qëllimet e informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>)

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>)

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO. (<http://www.simap.ch>).

**7.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Shërbimet e Ekspertëve dhe financimin e tyre gjatë Periudhës së Plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.**

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Marrësit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

### **8. Dispozita të ndryshme**

8.1 Marrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcë (*Zotimet e Përputhshmërisë*).

8.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj, plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Marrësi nuk mund të caktojë, transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

8.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit të përcaktuara në këtë Marrëveshje, përfundojnë gjashtë vjet pas disbusimit të fundit.

8.6 Kjo Marrëveshje Granti hyn në fuqi dhe efekt jo më parë se KfW-ja të ketë marrë njoftim me shkrim nga Marrësi se procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushen nga Marrësi, kanë përfunduar (data e pranimit në KfW).

Nëse Marrëveshja e Grantit nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Granti, ose në ndonjë afat tjetër siç mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja e Grantit dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Marrësit.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.  
Frankfurt am Main, 29 dhjetor 2022

### **Republika e Shqipërisë**

Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Emri: Delina Ibrahim**

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

### **KfW**

**Emri: Arne Gooss**

Pozicioni: Shef i divizionit të Infrastrukturës Komunale të Evropës Juglindore dhe Turqisë

**Emri: Britt Horschke**

Pozicioni: Drejtor Vendi i KfW

### **Shtojca**

Zotimet e Përputhshmërisë

## **SHTOJCË**

### **Zotimet e Përputhshmërisë**

#### **1. PËRKUFIZIME**

**Praktikë Shtrënguese:** dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë



të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi;

**Praktikë e Fshehtë:** është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

**Praktikë Korruptive:** premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

**Praktikë Mashtruese:** nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

**Praktikë Penguese:** (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, Praktike të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese ose Praktike të Fshehtë.

**Person:** një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

**Praktikë e Sanksionueshme:** çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese, ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: (i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që (ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

**Sanksione:** sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike,

financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

**Organ Sanksionues:** Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

**Listë e Sanksioneve:** çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, të lëshuar nga ndonjë Organ Sanksionues.

## 2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi, përmes NJKP-së

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Marrësin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Shërbimet e Ekspertëve, të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Marrësin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Shërbimet e Ekspertëve;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave në të gjitha instalimet lidhur me Shërbimet e Ekspertëve, për qëllimet e kësaj shtojce.

## 3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Marrësit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për Shërbimet e Ekspertëve, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në Praktikë të



Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

#### 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Marrësi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

#### 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Shërbimet e Ekspertëve që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

### VENDIM

Nr. 183, datë 29.3.2023

## **PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT SECO NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW *FRANKFURT AM MAIN* (KfW), PËR PROGRAMIN PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit SECO, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW *Frankfurt am Main* (KfW),

për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

**Edi Rama**

### **MARRËVESHJE GRANTI SECO**

E DATËS 29.12.2022, NDËRMJET KfW,

FRANKFURT AM MAIN

(“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(“PËRFITUESI”), TË PËRFAQËSUAR NGA

MINISTRIA E FINANCAVE DHE

EKONOMISË PËR SHUMËN

EUR 4,750,000.00

- PROGRAMI PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE -

### PËRMBAJTJA

Neni

Preambulë

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

2. Disbursimi

3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

4. Kostot dhe detyrimet publike

5. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit

6. Programi

7. Publikimi dhe transferimi i Informacionit lidhur me Programin

8. Përfundimi i Marrëveshjes

9. Dispozita të Ndryshme

Zotimet e Përputhshmërisë

### Preambulë

Programi për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve (siç specifikohet në nenin 1.2 më poshtë) do të bashkëfinancohet nga Konfederata Zvicerane (“**Kontributi Zviceran**”) dhe Republika Federale e Gjermanisë (“**Kontributi Gjerman**”).

Kontributi Zviceran do t’i vihet në dispozicion Përfituesit nëpërmjet KfW-së, me anë të kësaj Marrëveshjeje Granti (“**Marrëveshja e Grantit**” ose “**Marrëveshja**”).

Kontributi Gjerman do të vihet në dispozicion përmes KfW-së me anë të një marrëveshjeje huaje (“**Marrëveshja e Huas**”), një marrëveshje granti



për investime (**“Marrëveshja e Grantit për Investimin”**), si dhe një marrëveshje granti për masat shoqëruuese (**“Marrëveshja e Grantit për Masat Shoqëruuese”**), të gjitha të së njëjtës ose rreth kësaj datë me këtë marrëveshje dhe bazohet në marrëveshjen e **datës 27 janar 2021** ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (**“Marrëveshja e Qeverisë”**).

Baza për këtë Marrëveshje është marrëveshja ndërmjet Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (**“SECO”**) dhe KfW-ja, e datës 15 dhjetor 2021 (**“Marrëveshja e Delegimit”**).

Bazuar në sa më sipër, Përfituesi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të Grantit:

### 1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk tejkalon shumën prej 4,750, 000,00 eurosh (me fjalë: katër milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro) (**“Granti”**).

Çdo e ardhur e mundshme nga interesi nga Granti i krijuar si rezultat i mbajtjes së Grantit nga KfW-ja në një llogari të caktuar për SECO-n, mund t'i jepet Përfituesit përveç Grantit, me pëlqimin e SECO-s. Në këtë rast, KfW-ja do të informojë Përfituesin për çdo fond të tillë shtesë në dispozicion të Përfituesit.

Ky Grant nuk do të jetë i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë Grantin vetëm për të financuar konsulentin e implementimit dhe konsulentin e masave shoqëruuese, në kuadrin e Programit për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta (**“Programi”**), dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (**“MIE”**), e cila vepron nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (**“Njësia e Koordinimit të Programit”** ose **“NJKP”**) do të veprojë si njësia e koordinimit të projektit për drejtimin, koordinimin e përgjithshëm të projektit dhe zbatimin e Programit

NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti, duke nënshkruar një marrëveshje të veçantë (**“Marrëveshja e**

**Veçantë”**), e cila, gjithashtu, do të nënshkruhet si e lexuar dhe rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që vepron në emër të Përfituesit.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të paguhen nga Përfituesi, si edhe tarifat e importit nuk do të financohen nga Granti.

### 2. Disbursimi

2.1. KfW-ja do të disbursojë Grantin në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesë të Përfituesit që vepron nëpërmjet NJKP-së. Nëpërmjet Marrëveshjes së Veçantë, e cila do të nënshkruhet si e lexuar dhe rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që vepron në emër të Përfituesit, NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 shtator 2028.

### 3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

3.1. KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Granti, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit për Investimin, Marrëveshjes së Grantit për Masat Shoqëruuese ose sipas marrëveshjeve të veçanta, në lidhje me këtë Marrëveshje Granti ose marrëveshjet e lartpërmendura;

c) Përfituesi nuk mund të provojë se shumatat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadrin të kësaj Marrëveshjeje Granti shkel ligjin e zbatueshëm;

e) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin ose qëllimin e Programit; ose

f) disbursimet nga SECO në KfW janë pezulluar ose vonuar ose Marrëveshja e Delegimit është përfunduar ose nuk ka më efekt detyrues;

g) Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Grantit për Investimin ose Marrëveshja e Grantit për Masat Shoqëruuese nuk kanë hyrë në fuqi ose ka ndodhur një rast i cili lejon KfW-në që të pezullojë disbursimet në përputhje me marrëveshjet e lartpërmendura; ose



h) kjo Marrëveshje Granti është përfunduar në përputhje me nenin 8.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 3.1b), c) ose d)) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

a) në rastet e parashikuara në nenin 3.1b) ose d) të kërkojë: i. shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara; dhe ii. pagesën e menjëhershme të çdo shume tjetër të pagueshme në lidhje me këtë Marrëveshje Granti;

b) në rastet e përcaktuara në nenin 3.1c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave, kur Përfituesi nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

#### 4. Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Granti, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Grantit.

#### 5. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej ministrit të Financave dhe Ekonomisë për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij do të përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet që kërkohen për zbatimin e Marrëveshjes së Grantit. Tagri i përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të shprehur nga përfaqësuesi i Përfituesit i autorizuar në atë kohë.

5.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuale, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Granti bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Granti që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë menjëherë, pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuale përkatëse ose në adresa të tjera

të palës kontraktuale përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Republika Federale e Gjermanisë  
Fax: +49 69 7431-2944

Për Përfituesin: Republika e Shqipërisë  
Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
nr. 3  
1001 Tiranë, Shqipëri

#### 6. Programi

##### 6.1 Nëpërmjet NJKP-së, Përfituesi:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Programin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e rënë dakord ndërmjet NJKP-së dhe KfW-së për Programin;

b) do të caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e Programit firmave të kualifikuara;

c) do të pajtohet në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të sigurojë financimin e plotë të Programit dhe do t'i vërë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga ky Grant;

e) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant;

f) do t'i mundësojë në çdo kohë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me implementimin dhe funksionimin e Programit;

g) do t'i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së dhe/ose SECO-s të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;





h) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet mbi Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

i) do të informojë menjëherë KfW-në, me nismën e saj për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht implementimin, funksionimin ose qëllimin e Programit;

j) në rast të krijimit të një komiteti drejtues ose të një organi të ngjashëm në lidhje me Programin, do të informojë KfW-në dhe SECO-n për një krijim të tillë dhe do të sigurohet që KfW-ja dhe SECO-ja të kenë të drejtë të emërojnë të paktën një anëtar në këtë organ;

k) nëse Përfituesi nuk ka krijuar një komitet drejtues ose një organ të ngjashëm, sipas nenit 6.1k) më sipër, KfW-ja mund (por nuk do të jetë i detyruar) t'i kërkojë Përfituesit të krijojë një komitet të tillë drejtues ose një organ të ngjashëm, ku në këtë rast ky komitet ose organ do të përbëhet nga përfaqësues të Përfituesit, KfW-së dhe SECO-s dhe do të jetë i autorizuar të marrë vendime strategjike në lidhje me Programin;

l) do të lejojë vlerësime të mëtejshme të Programit dhe rezultateve të Programit nga përfaqësues të KfW-së dhe SECO-s, agjentë të jashtëm ose një auditor (i jashtëm) të porositur nga KfW-ja dhe/ose SECO-ja; dhe

m) do të sigurojë vizibilitetin e Kontributit Zviceran në Program, p.sh. që i gjithë materiali i marrëdhënieve me publikun dhe të gjitha dokumentet e prodhuara në kuadër të Programit përfshijnë një referencë për faktin se Programi është i bashkëfinancuar nga Qeveria Zvicerane dhe logoja e Qeverisë Zvicerane shfaqet, veçanërisht në tabelat e vendosura në kantieret e ndërtimit.

6.2 NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet lidhur me nenin 6.1 në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet gjithashtu si e lexuar nga Ministria e Financave.

## **7. Publikimi dhe transferimi i Informacionit lidhur me Programin**

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas Projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e

marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Programin ose në financimin e tij, të tillë si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

7.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë seksione të lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë. për qëllimet e Iniciativës së Transparencës të Ndihmës Ndërkombëtare





([http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen\\_fakt/en/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html](http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakt/en/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html));

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>);

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<https://www.deval.org/en/>);

7.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja të palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

### 8. Përfundimi i Marrëveshjes

Nëse Marrëveshja e Delegimit është përfunduar ose pushon të ketë ndonjë efekt detyrues për arsye të tjera, KfW-ja mund ta përfundojë këtë Marrëveshje Granti me efekt të menjëhershëm, duke sjellë kështu pasojat e mëposhtme:

a) Detyrimet e KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje Granti, do të anulohen plotësisht;

b) pa cenuar të drejtat e KfW-së, sipas nenit 3.2, KfW-ja do të ketë të drejtë të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të disbursuara të Grantit deri në masën që këto shuma nuk janë kryer ende ose shpenzuar nga Përfituesi në një mënyrë ligjërish të detyrueshme, në përputhje me këtë Marrëveshjeje Granti.

### 9. Dispozita të ndryshme

9.1 Përfituesi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcë (*Zotimet e Përputhshmërisë*).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Granti është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Përfituesi nuk mund të caktojë, transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshjeje Granti rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit të përcaktuara në këtë Marrëveshje, do të përfundojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo Marrëveshjeje Granti hyn në fuqi dhe efekt jo më parë se KfW-ja të ketë marrë njoftim me shkrim nga Përfituesi që procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushen nga Përfituesi, kanë përfunduar (data e pranimi në KfW).

Nëse Marrëveshja e Grantit nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Granti ose në ndonjë afat tjetër, siç mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja e Grantit dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Përfituesit.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, 29 dhjetor 2022.

KfW

**Republika e Shqipërisë**  
Përfaqësuar nga Ministria  
e Financave dhe  
Ekonomisë

**Emri: Arne Gooss**

Pozicioni: Shef i divizionit të  
Infrastrukturës Komunale të  
Evropës Juglindore dhe  
Turqisë

**Emri: Delina Ibrahim**

Pozicioni: Ministër i  
Financave dhe  
Ekonomisë

**Emri: Britt Horschke**

Pozicioni: Drejtor Vendi i  
KfW-së



SHTOJCA  
AKTI I PËRPUTHSHMËRISË

SHTOJCË  
ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË

1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë Shtrënguese”**, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim i për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi;

**“Praktikë e Fshthtë”** është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

**“Praktikë Korruptive”**, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

**“Praktikë Mashtruese”** nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

**“Praktikë Penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmimeve të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, Praktike të Fshthtë ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese ose Praktike të Fshthtë.

**“Person”**, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

**“Praktikë e sanksionueshme”**, çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshthtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

**“Sanksione”**, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

**“Organ Sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e Sanksioneve”**, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë Organ Sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Përfituesi, përmes NJKP-së

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit



tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në të gjitha instalimet lidhur me Projektin, për qëllimet e kësaj shtojce.

### 3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të Pagesës së Interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

### 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

### 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

## VENDIM

**Nr. 184, datë 29.3.2023**

### **PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT TË INVESTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE TË NGURTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me

propozimin të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi Rama**

### **MARRËVESHJE GRANTI PËR INVESTIMIN**

**E DATËS 29.12.2022 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”)**

**DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“PËRFITUESI”) TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR SHUMËN**

**6,900,000.00 EURO**

**- PROGRAMI PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE TË NGURTA -**

**BMZ - NR. 2018 67 167**

## PËRMBAJTJA

### NENI

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
  2. Disbursimi
  3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja
  4. Kostot dhe detyrimet publike
  5. Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit
  6. Programi
  7. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Programin
  8. Dispozita të ndryshme
- Zotimet e përputhshmërisë

Në bazë të marrëveshjes së datës 27 janar 2021 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së



Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (“**Marrëveshja e Qeverisë**”), Përfituesi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të Grantit (“**Marrëveshja e Grantit**” ose “**Marrëveshja**”).

Kjo Marrëveshje është pjesë e Programit **për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta (“Programi”)**.

Programi do të zbatohet nëpërmjet financimit të kësaj Marrëveshjeje Granti për Investimin, marrëveshjes së huas (“**Marrëveshja e Huas**”), marrëveshjes së grantit të financuar nga SECO (“**Marrëveshja e grantit SECO**”) dhe marrëveshjes së grantit për masat shoqëruese (“**Marrëveshja e Grantit për Masat Shoqëruese**”), të gjitha të së njëjtës me këtë marrëveshje.

### **1. Shuma dhe Qëllimi i Grantit**

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk tejkalon shumën prej **6.9.000.000,00 euro (me fjalë: gjashtë milionë e nëntëqind mijë euro)** (“Granti”).

Ky Grant nuk do të jetë i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë Grantin vetëm për të financuar masat prioritare të mbrojtjes së mjedisit në kuadrin e Programit për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta (“Programi”), dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”), e cila vepron nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (“Njësia e Koordinimit të Programit” ose “NJKP”) do të veprojë si njësia e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin e përgjithshëm të projektit dhe zbatimin e Programit.

NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti, duke nënshkruar një marrëveshje të veçantë (“**Marrëveshja e Veçantë**”), e cila, gjithashtu, do të nënshkruhet si e lexuar dhe e rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që vepron në emër të Përfituesit.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të paguhen nga Përfituesi, si edhe tarifatat e importit nuk do të financohen nga Granti.

### **2. Disbursimi**

2.4 KfW-ja do të disbursojë Grantin në përputhje me progresin e Programit dhe me

kërkesë të Përfituesit. Nëpërmjet Marrëveshjes së Veçantë, e cila do të nënshkruhet si e lexuar dhe e rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që vepron në emër të Përfituesit, NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.5 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 shtator 2028.

### **3. Përzullimi i disbursimit dhe shlyerja**

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Granti, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Grantit SECO, Marrëveshjes së Grantit për Masat Shoqëruese ose sipas marrëveshjes të veçantë në lidhje me këtë Marrëveshje Granti,

c) Përfituesi, nuk mund të provojë se shumatat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadrin të kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin ose qëllimin e Programit; ose

f) Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Grantit SECO ose Marrëveshja e Grantit për Masat Shoqëruese nuk kanë hyrë në fuqi ose ka ndodhur një rast i cili lejon KfW-në që të pezullojë disbursimet në përputhje me marrëveshjet e lartpërmendura.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuar në nenin 3.1 b), c) ose d) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja:

g) në rastet e parashikuara në nenin 3.1 b) ose d) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

h) në rastet e përcaktuara në nenin 3.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave kur Përfituesi, nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.



#### **4. Kostot dhe detyrimet publike**

Përfituesi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Grantit.

#### **5. Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit**

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej ministrit të Financave dhe Ekonomisë për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara prej tij do të përfaqësojnë Përfituesin në të gjitha veprimet që kërkohen për zbatimin e Marrëveshjes së Grantit. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të shprehur nga përfaqësuesi i Përfituesit i autorizuar në atë kohë.

5.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuale, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë menjëherë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuale përkatëse, ose në adresa të tjera të palës kontraktuale përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuale:

##### **Për KfW-në:**

KfWPostfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Republika Federale e Gjermanisë  
Faks: +49 69 7431-2944

##### **Për Përfituesin:**

Republika e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Nr. 31001, Tiranë, Shqipëri

#### **6. Programi**

##### **6.1 Nëpërmjet NJKP-së, Përfituesi**

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Programin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në

përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me konceptin e rënë dakord ndërmjet NJKP-së dhe KfW-së për Programin;

b) do të caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e Programit firmave të kualifikuara;

c) do të pajtohet në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të sigurojë financimin e plotë të Programit dhe do t'i vendosë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të kësaj të fundit, dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të paguara nga ky Grant;

e) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant;

f) do t'i mundësojë në çdo kohë përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë ato libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin dhe funksionimin e Programit, dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet lidhur me të;

g) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet mbi Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja; dhe

h) do të informojë KfW-në, me nismën e saj për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit.

6.2 NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet lidhur me nenin 6.1 në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet, gjithashtu, si e lexuar nga Ministria e Financave.

6.3 Për transportin e mallrave që do të financohet nga Granti, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Përfituesin.

#### **7. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Programin**

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe të efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe



raportet e vlerësimit ex post (pas Projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “**Periudha e Plotë**”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Programin ose në financimin e tij, të tillë si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhëna personale për personat fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

7.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) Sekretariatit e Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë seksione të lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë. për qëllimet e Iniciativës së Transparencës të Ndihmës Ndërkombëtare

(<https://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/internationale-transparenzstandards-59280>);

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>);

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<https://www.deval.org/en/>);

e) Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO. (<http://www.simap.ch>).

7.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t’iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

## 8. Dispozita të Ndryshme

8.1 Përfituesi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcë (*Zotimet e Përputhshmërisë*).

8.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Përfituesi nuk mund të caktojë, transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.



8.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit të përcaktuara në këtë Marrëveshje, do të përfundojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.6 Kjo Marrëveshje Granti hyn në fuqi dhe efekt jo më parë se KfW-ja të ketë marrë njoftim me shkrim nga Përfituesi që procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushen nga Përfituesi, kanë përfunduar.

Nëse Marrëveshja e Grantit nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Granti, ose në ndonjë afat tjetër, siç mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja e Grantit dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Përfituesit.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.  
Frankfurt am Main, 29 dhjetor 2022.

KfW

---

**Emri: Arne Gooss**

Pozicioni: Shef i Divizionit të Infrastrukturës  
Komunale të Evropës Juglindore dhe Turqisë

---

**Emri: Britt Horschke**

Pozicioni: Drejtor Vendi i KfW

---

**Republika e Shqipërisë**

Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë

---

**Emri: Delina Ibrahim**

Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

## SHTOJCA AKTI I PËRPUTHSHMËRISË

### SHTOJCË ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË

#### 1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë Shtrënguese”**, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

**“Praktikë e Fshehtë”** është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

**“Praktikë Korrutive”**, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

**“Praktikë Mashtruese”** nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

**“Praktikë Penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmimeve të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korrutive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, Praktike të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korrutive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese ose Praktike të Fshehtë.

**“Person”** një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.



**“Praktikë e sanksionueshme”**, çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshtë, Praktikë Korrutive, Praktike Mashtuese ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

**“Sanksione”**, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

**“Organ Sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e Sanksioneve”** çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë Organ Sanksionues.

## 2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Përfituesi, përmes NJKP-së

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Përfituesin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Përfituesin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit

tjetër të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në të gjitha instalimet lidhur me Projektin, për qëllimet e kësaj shtojce.

## 3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Përfituesit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Përfituesit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të Pagesës së Interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

## 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj sapo Përfituesi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

## 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të Sanksioneve.



**VENDIM****Nr. 185, datë 29.3.2023**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË  
HOLLËSISHME PËR TË DHËNAT  
PARËSORE DHE DYTËSORE,  
RREGULLAT PËR NDËRVEPRIMIN ME  
BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE  
SHTETËRORE DHE NIVELIN E  
AKSESIMIT NË REGJISTRIN  
ELEKTRONIK TË GJENDJES  
GJYQËSORE TË SHTETASVE TË  
DËNUAR JASHTË VENDIT, POR ME  
BANIM TË PËRHERSHËM NË SHTETIN  
SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 29, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave të hollësishme për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, rregullat për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në këtë bazë të dhënash në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit.

2. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit është një bazë e të dhënave shtetërore, nëpërmjet së cilës grumbullohet informacioni i organizuar dhe i ruajtur në formë elektronike për çdo vendim penal të formës së prerë, të dhënë nga autoritetet e huaja ndaj shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj ose pa shtetësi, por me banim të përhershëm në shtetin shqiptar, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

3. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit administrohet e mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë, në për-

puthje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

4. Përpunimi i të dhënave personale në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit kryhet në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

**II. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK TË GJENDJES GJYQËSORE TË SHTETASVE TË DËNUAR JASHTË VENDIT**

5. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit përmban të dhënat për çdo vendim penal të dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj ose pa shtetësi, por me banim të përhershëm në shtetin shqiptar, që rezultojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010.

6. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit përmban të dhëna për:

- a) gjendjen civile të personit të dënuar;
- b) shtetin në të cilin është dënuar personi dhe autoriteti gjyqësor që ka dhënë dënimin;
- c) vendimin penal të autoritetit gjyqësor të huaj;
- ç) veprën penale për të cilën është dënuar;
- d) masën e dënimit;
- dh) shtetin e ekzekutimit të vendimit penal.

7. Të dhënat e regjistrit të shtetasve të dënuar jashtë shtetit në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore.

8. Të dhënat parësore, që përmban regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, janë:

- a) shteti në të cilin është dënuar personi;
- b) autoriteti gjyqësor që ka dhënë dënimin;
- c) të dhënat e vendimit penal të autoritetit gjyqësor të huaj, si numri i vendimit, data e vendimit dhe dispozitivi i vendimit;
- ç) vepra penale për të cilën është dënuar;
- d) masa e dënimit;
- dh) shteti i ekzekutimit të vendimit penal;
- e) të dhëna nëse vendimi penal është dhënë në mungesë, nëse ekzekutimi i dënimit penal është parashkruar apo nëse i dënuari është rehabilituar.

9. Të dhënat dytësore, që përmban regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, janë:



a) të dhëna lidhur me përbërës të gjendjes civile, si emri, mbiemri, numri personal, numri personal për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, datëlindja, vendlindja, gjinia, emri i babait, emri i nënës, gjendja civile, të dhënat për vendbanimin dhe vendqëndrimin;

b) të dhëna referenciare nga ndërveprimi me baza të dhënash të tjera, sipas pikës 10, të këtij vendimi.

### III. NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE DHE NIVELI I AKSESIMIT PËR SUBJEKTET E INTERESUARA

10. Regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit ndërvepron me baza të tjera të dhënash, të cilat janë:

a) të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) sistemi elektronik i regjistrimit të çështjeve gjyqësore në Shqipëri;

c) regjistri i çështjeve penale në Shqipëri;

ç) të dhëna nga baza e të dhënave të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë të autoriteteve juridiksionale të huaja, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjellë.

11. Dhënës i informacionit për bazën e të dhënave në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit është:

a) Çdo mision diplomatik në shtetin e huaj;

b) çdo autoritet tjetër publik që merr dijeni për dënimin me vendim të formës së prerë nga një gjykatë e huaj për një shtetas shqiptar, shtetas i huaj apo pa shtetësi, por me banim të përhershëm në shtetin shqiptar.

12. Subjekte të interesuara janë:

a) organi i prokurorisë;

b) Policia e Shtetit;

c) organet e tjera të hetimit;

ç) çdo subjekt tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj apo me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) çdo person i interesuar, të cilit i njihet legjërisht kjo e drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të regjistrit elektronik të gjendjes gjyqësore, të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe pa shtetësi, të dënuar jashtë vendit, por me banim të përhershëm në shtetin shqiptar është, si më poshtë vijon:

a) Veprimet në regjistër kryhen nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, e cila ka të drejta regjistrimi, përpunimi, raportimi, leximi, shkrimi dhe përditësimi për të dhënat e regjistruara në regjistër;

b) Subjektet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në leximin e të dhënave, kur është e nevojshme për të hetuar një vepër penale;

c) Subjektet e interesuara, të përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 11, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi të të dhënave të regjistrit elektronik.

14. Subjektet që kanë akses në regjistër ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, që aksesojnë nëpërmjet regjistrit.

15. Në rastin kur vendimet e dhëna nga autoritetet e huaja ndaj shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj ose pa shtetësi janë njohur nga autoritetet shqiptare, vendimet e dhëna nga autoritetet e huaja nuk regjistrohen në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit.

### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

16. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të regjistrit elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit miratohet nga ministri i Drejtësisë, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara, sipas nenit 10, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

17. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 186, datë 29.3.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 430, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË TIRANËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen të dhënat për pronën me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe planit të rëlevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Universiteti i Tiranës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**

| Institucion i Pushtetit qendror: Ministria e Arsimit dhe Sportit |                                  |              |                | Identifikoi:                                         |                           | Ark. Juzica Gjini, Specialist D.P.I |                                       | Ing. Egert Spahiu, Përgjegjës Sektori D.P.I       |                                                            | Supervizoi:                                      |  | Skerdi Dafa, Administrator i UT-së |  | Aprovoi: |  | Artan Hoxha, Rector i UT-së |  |
|------------------------------------------------------------------|----------------------------------|--------------|----------------|------------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--|------------------------------------|--|----------|--|-----------------------------|--|
| Bashkia: Tiranë                                                  |                                  |              |                | Fusha e përdorimit të Pronës: Universiteti i Tiranës |                           |                                     |                                       |                                                   |                                                            |                                                  |  |                                    |  |          |  |                             |  |
| Nr. Rend.                                                        | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës | Nr. Pasurisë | Lloji i Pronës | Emri i Pronës Adresa                                 | Sip. Totale e Pronës (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m2)   | Funksioni për të cilin përdoret Prona | Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative | Institucioni / Enti perdonues Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera Akti normativ i lënies në fuqi |  |                                    |  |          |  |                             |  |
| 1                                                                | 2                                | 3            | 4              | 5                                                    | 6                         | 7                                   | 8                                     | 9                                                 | 10                                                         | 11                                               |  |                                    |  |          |  |                             |  |
| 16                                                               | 8250/TR: R-8                     | 2/729: 2/214 | Godinë+Truall  | Bashkia Tiranë                                       | 2367.5                    | 1127.5                              | Arsim                                 | Universiteti i Tiranës                            | Fakulteti i Shkencave Sociale/Pronë Shtet                  | Vendimi nr. 648, datë 29/09/2011                 |  |                                    |  |          |  |                             |  |



**PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE**

PRONARI \_SHTET (Universiteti i Tiranes)      DATE \_14.11.2022      QELLIMI: PERDITESIM , REGJISTRIM

VENDNDODHJA  
BASHKIA\_TIRANË      DVASHK/ZVASHK\_TIRANE VERI      ZONA KADASTRALE\_8250      NUMRI PASURISE \_2/729      INDEX HARTE\_TR; R-8,R-9

TE DHENAT E PASURISE  
LLOJI PASURISE\_TRUALL      SIP.PASURISE= 2334 m2      SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = 1106 m2      NUMRI KATEVE \_\_\_\_\_      NUMRI PEMEVE \_\_\_\_\_

X- 483539.102      Y- 4576365.465      X- 483636.362      Y- 4576365.465

**KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE**

SH 1:500

X- 483539.102      Y- 4576300.899      X- 483636.362      Y- 4576300.899

**SHpjegues**

- SIP.TRUALL TOTALE PER KALIM PRONESIE SIP. = 2367.5 m2
- SIP.TRUALL PER KALIM PRONESIE PJESE E PAS 2/729= 2303.7 m2
- SIP.TRUALL PER KALIM PRONESIE PJESE E PAS 2/214= 63.8 m2
- NDERTESE PER KALIM PRONESIE SIP. = 1127.5 m2
- KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|-----|-----------|-----------|--------------|----------|---------|------------------------|
| 1   | V         |           |              | 2/730    |         |                        |
| 2   | J         |           |              | 2/214    |         |                        |
| 3   | L         |           |              | 2/685    |         |                        |
| 4   | P         |           |              | 2/680    |         |                        |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI:\_ERBLIN SKUKA\_

LICENCA: NR. T\_1014/2 DATE\_01.03.2021

KOMPANIA:\_GJEOKONSULT & CO\_

NIPT:\_K 91810005U\_

NENSHKRIMI/VULA

**REALIZOI PER ASHK**

SPECIALISTI \_\_\_\_\_

DVASHK \_\_\_\_\_

NENSHKRIMI \_\_\_\_\_

**KONFIRMOI**

PERGJEGJESI/DREJTORI \_\_\_\_\_

NENSHKRIMI / VULA \_\_\_\_\_

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T,O,S**

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: \_\_\_\_\_ HK \_\_\_\_\_

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**

EMRI \_SHTET\_

NENSHKRIMI \_\_\_\_\_

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



## UDHËZIM

Nr. 6, datë 23.3.2023

**RREGULLAT PËR KRYERJEN E  
KONTROLLEVE ZYRTARE NË LIDHJE  
ME KONTAMINANTËT NË USHQIM<sup>1,2</sup>**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, pikës 12, të nenit 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, dhe pikës 3, të nenit 81, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

## UDHËZOJ:

1. Miratimin e rregullave për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët në ushqim, sipas tekstit bashkëlidhur të këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

## RREGULLAT

PËR KRYERJEN E KONTROLLEVE  
ZYRTARE NË LIDHJE ME  
KONTAMINANTËT NË USHQIM

## Neni 1

Për qëllim të kësaj rregullore “Kontaminant” nënkupton çdo substancë që nuk i shtohet qëllimisht ushqimit, e cila është e pranishme në këtë ushqim, si rezultat i prodhimit (përfshirë veprimet e kryera në bujqësi, blegtori dhe mjekësi veterinare), prodhim, përpunim, përgatitje, trajtim, paketim, ambalazhim, transportim ose si rezultat i ndotjes së mjedisit. Lëndët e jashtme, si p.sh., fragmentet e insekteve, qimet e kafshëve etj. nuk mbulohen nga ky përkufizim.

## Neni 2

Kontrollet mbi praninë e kontaminantëve në ushqim kryhen në përputhje me kërkesat e aneksit I të këtij udhëzimi. Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV) harton strategjinë e kampionimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin II të këtij udhëzimi, vetëm në zbatim dhe në funksion të planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve.

<sup>1</sup> Ky udhëzim përaftron rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2022/931, të datës 23 mars 2022, duke plotësuar Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duke përcaktuar rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare, në lidhje me kontaminantët në ushqime.

<sup>2</sup> Rregulloren e Këshillit (EEC) nr. 315/93, të datës 8 shkurt 1993, që përcakton procedurat komunitare për ndotësit në ushqim.



## ANEKSI I

## RREGULLAT PËR ZGJEDHJEN E NJË KOMBINIMI SPECIFIK TË KONTAMINANTËVE OSE GRUPEVE TË KONTAMINANTËVE DHE GRUPEVE TË PRODUKTEVE

1. Kontrolli i kombinimeve të kontaminantëve ose grupeve të kontaminantëve në grupet e produkteve të mëposhtme kryhet sipas tabelës së mëposhtme:

| Grupet e produkteve                                                                                       | Ndotës organike të qëndrueshëm halogjenë | Metalet | Mykotoksina | Ndotës të tjerë |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|---------|-------------|-----------------|
| Mishi i gjedhit, dhenve, dhive të pa ërpunuara (përfshirë të brendshmet e konsumueshme)                   | x                                        | x       |             | x               |
| Mishi i derrit i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme)                                     | x                                        | x       |             | x               |
| Mishi i kalit i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme)                                      |                                          | x       |             | x               |
| Mishi i pulës i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme)                                      | x                                        | x       |             | x               |
| Mishi i kafshëve të tjera të tokës të mbarështuara i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme) |                                          | x       |             |                 |
| Qumështi i freskët i gjedhit, dhenve dhe dhive                                                            | x                                        | x       | x           | x               |
| Vezët e pulave dhe vezë të tjera të freskëta                                                              | x                                        | x       |             | x               |
| Mjalti                                                                                                    |                                          | x       |             | x               |
| Produkte të peshkut të papërpunuar (me përjashtim të krustaceve)                                          | x                                        | x       |             | x               |
| Krustacet dhe molusqet bivalvore                                                                          | x                                        | x       |             | x               |
| Dhjami dhe vajra shtazore dhe detare                                                                      | x                                        | x       |             | x               |
| Produkte të përpunuara me origjinë shtazore                                                               | x                                        | x       |             | x               |

2. SPV-ja gjatë hartimit të strategjisë së kampionimit merr parasysh të gjitha kombinimet e kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve që përbëhen nga ushqime me origjinë joshkëzore, për të cilët legjislacioni kombëtar përcakton nivele maksimale të mbetjeve ose nivele të tjera rregullatore sipas legjislacionit kombëtar.

3. SPV-ja merr në konsideratë kriteret që vijnë për të përzgjedhur kombinimet specifike të ndotësve ose grupeve të ndotësve dhe grupeve të produkteve që do të kontrollohen:

a) frekuencën e gjetjeve në rastet jokonforme, rastet jokonforme të njoftuar në kuadër të sistemit të alarmit të shpejtë për ushqimet dhe ushqimet për kafshë ose të sistemit të bashkëpunimit administrativ sipas marrëveshjeve ndërkombëtare;

b) disponueshmërinë e metodave laboratorike dhe standardeve analitike të përshtatshme;

c) mundësinë e riskut për konsumatorët ose për grupe të caktuara të popullsisë, që rrjedh nga konsumi i ushqimeve me përmbajtje të ndotësve, duke mbajtur parasysh informacionet përkatëse të njoftuara nga autoritetet ndërkombëtare për

sigurinë ushqimore, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria është pjesë e tyre ose në mungesë të këtyre informacioneve, nga burime të tjera informacioni, të tilla si botimet shkencore ose vlerësimet e riskut kombëtar;

d) të dhënat mbi konsumin (modele dietike ushqimore);

e) për sa u përket ushqimeve që hyjnë që importohen dhe eksportohen, në hartimin e planeve të kontrollit merren në konsideratë edhe kriteret që vijnë nëse janë të disponueshme:

i. rezultatet e kontrollit të kryera nga organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, sipas marrëveshjeve përkatëse;

ii. çdo lloj informacioni që vendos në dyshim besueshmërinë e garancive që i përket përputhshmërisë së ushqimeve të importuara me legjislacionin përkatës në fuqi;

iii. informacionet mbi vigjencën e përforcuar.





## ANEKSI II KRITERET PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË KAMPIONIMIT

1. Për secilin operator të biznesit ushqimor që do të kontrollohet duhet të mbahen parasysh kriteret që vijojnë për përzgjedhjen e tipit të ushqimit që do të kontrollohet:

a) rastet jokonforme të gjetura gjatë vitit paraardhës;

b) mangësitë në zbatimin e analizës së rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit dhe të autokontrolleve përkatëse;

c) mangësitë në mbajtjen e të dhënave siç përcaktohet në udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”;

d) kampionimi përfaqësues pavarësisht nga madhësia e operatorit të biznesit ushqimor;

e) situatat emergjente (ndryshimet në modelet e konsumit, fatkeqësitë natyrore ose problemet ekonomike që shkaktojnë ndryshime në zinxhirët e tregtisë ushqimore etj.).

2. SPV-ja, në hartimin e strategjisë së kampionimit merr parasysh kriteret që vijojnë për përzgjedhjen e thertoreve, njësitë e prerjes, stabilimenteve për prodhimin e qumështit, stabilimenteve për prodhimin dhe futjen në treg të produkteve të peshkut dhe produkteve të akuakulturës, stabilimenteve për prodhimin e mjalit, vezëve dhe qendrave të ambalazhimit të vezëve:

a) kriteret e listuara në aneksin I, pika 3, dhe të pikës 1 të këtij aneksi;

b) vëllimin e prodhimit total gjatë vitit të fundit që u përket thertoreve, njërive të prerjes, stabilimenteve të prodhimit të qumështit, stabilimenteve të prodhimit dhe futjes në treg të produkteve të peshkut dhe të akuakulturës, stabilimenteve të prodhimit të mjalit, vezëve dhe qendrave të ambalazhimit të vezëve;

c) origjinën e kafshëve të therura, të qumështit, të produkteve të akuakulturës, mjalit dhe vezëve.

3. Në momentin e marrjes së kampioneve nevojitet që të bëhet e mundur parandalimi i kampionimit të shumëfishtë pranë të njëjtit operator të sektorit ushqimor, me përjashtim të rastit kur operatori është përzgjedhur në bazë të kriterëve të përshkruar në pikën 1 ose kur jepet një

argumentim i saktë në planin e kontrollit. Duhet të garantohet respektimi i frekuencës së parashikuar në planin e kontrolleve.

4. Për sa i përket ushqimit që përfshihet në objektin e planit të kontrollit për ushqimin e vendosur në tregun në vend, kampionimi do të kryhet në ushqimin e vendosur në treg dhe në ushqimin e synuar për t’u vendosur në treg (prodhimi primar, mbarështim në sistem të hapur, në thertore, gjatë përpunimit të ushqimit, ruajtjes ose tregtimit të tij).

## UDHËZIM

Nr. 7, datë 23.3.2023

### RREGULLAT PËR HARTIMIN, PËRMBAJTJEN E PLANEVE TË KONTROLLEVE ZYRTARE, PËR SA U PËRKET KONTAMINANTËVE NË USHQIM<sup>3</sup>

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe pikës 12 të nenit 41, të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar

## UDHËZOJ:

1. Miratimin e rregullave për hartimin, përmbajtjen e planeve të kontrolleve zyrtare për sa u përket kontaminantëve në ushqim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit; Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

<sup>3</sup> Ky udhëzim përaftron rregulloren e deleguar (BE) 2022/932 të Komisionit, datë 9 qershor 2022, “Mbi masat praktike uniforme për kryerjen e kontrolleve zyrtare, në lidhje me kontaminantët në ushqim, mbi përmbajtjen specifike shtesë të planeve kombëtare shumëvjeçare të kontrollit dhe masat specifike shtesë për përgatitjen e tyre”.

**RREGULLAT****PËR HARTIMIN, PËRMBAJTJEN E  
PLANEVE TË KONTROLLEVE ZYRTARE,  
PËR SA U PËRKET KONTAMINANTËVE  
NË USHQIM**

## Neni 1

**Objekti dhe fusha e zbatimit**

Ky udhëzim përcakton mënyrat praktike dhe uniforme të kontrolleve zyrtare mbi praninë e kontaminantëve në ushqim, për sa u përket:

- a) frekuencës minimale të kontrolleve zyrtare mbi praninë e kontaminantëve në ushqim; dhe
- b) përmbajtjen specifike të planeve kombëtare të kontrollit.

## Neni 2

**Përkufizime**

Për qëllimet e këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për Ushqimin”, të ndryshuar; udhëzimin nr. 13, datë 31.5.2018, “Mbi përcaktimin e metodave të kampionimit dhe analizës për kontrollin e niveleve të dioksinave, PCB-ve të ngjashme me dioksinat dhe PCB-ve jo të ngjashme me dioksinat në disa ushqime”; udhëzimin nr. 20, datë 25.11.2010, “Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore”; udhëzimin nr. 22, datë 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

## Neni 3

**Kërkesa të përgjithshme**

Plani që u përket kontrolleve zyrtare mbi praninë e kontaminantëve në ushqime përfshin:

- a) një “plan kontrolli për ushqimin e vendosur në treg” sipas përshkrimeve të nenit 4; dhe
- b) një “plan kontrolli për ushqimin me origjinë shtazore që importohen në vend”, sipas përshkrimeve të nenit 5.

## Neni 4

**Plani kontrollit për ushqimet e vendosura  
në treg**

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, vetëm në zbatim dhe në funksion të planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve harton një plan, në lidhje me praninë e kontaminantëve ose grupeve të kontaminantëve për ushqimet e vendosura në treg, përveç ushqimeve me origjinë shtazore të importuara. Ky plan mbulon kontrollet zyrtare për ushqimin e prodhuar në vend, ushqimin me origjinë joshstazore të importuar, si edhe produktet e përbëra.

Plani i kontrollit për ushqimet e vendosura në treg përcakton:

- a) listën e kombinimeve të kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve, që duhet të kontrollohen, në përputhje me aneksin I të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2023, “Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët në ushqim”;
- b) strategjinë e kampionimit, në përputhje me aneksin II të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2023, “Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët në ushqim”;
- c) frekuencën e kontrollit të vendosur duke mbajtur parasysh frekuencën minimale të kontrolleve vjetore sipas aneksit I të këtij udhëzimi.

Planet e kontrollit mund të përfshijnë informacione mbi kontrollet që u përkasin kombinimeve të kontaminantëve ose grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve për të cilat legjislacioni kombëtar përcakton nivele maksimale kombëtare.

## Neni 5

**Plani i kontrollit për ushqimet me origjinë  
shtazore të importuara**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, vetëm në zbatim dhe në funksion të Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve harton një plan kontrolli për praninë e kontaminantëve ose grupeve të kontaminantëve në ushqimet me origjinë shtazore të importuara të destinuara për t'u vendosur në treg. Ky plan do të mbulojë kontrollet zyrtare për





ushqimin me origjinë shtazore të importuara të destinuara për t'u vendosur në treg dhe produktet peshkore, të cilat transportohen në anije peshkimi, kur ato kryejnë një ndalesë në një port të vendit.

2. Plani i kontrollit për ushqimet me origjinë shtazore që hyjnë në vend përmban:

a) listën e kombinimeve të kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve që do të kontrollohen, në përputhje me aneksin I të udhëzimit nr. 6 datë 23.3.2023, “Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët në ushqim”;

b) strategjinë e kampionimit në përputhje me aneksin II të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2023, “Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare në lidhje me kontaminantët në ushqim”;

c) frekuencën e kontrolleve, duke mbajtur parasysh frekuencën minimale të kontrolleve zyrtare vjetore, sipas aneksit II të këtij udhëzimi.

3. Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, mundet të përfshijë në planet e kontrollit informacione mbi kontrollin që u përket kombinimeve të kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve për të cilat legjislacioni kombëtar përcakton nivele maksimale kombëtare.

Neni 6

#### Kërkesa të përbashkëta për planet e kontrollit

Planet e kontrollit sipas nenit 3 përmbajnë edhe:

a) Një argumentim për kombinimet e përzgjedhura të kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve, duke arsyetuar një shpjegim, se si janë marrë parasysh

kriteret e renditura në aneksin I të udhëzimit nr. 6 datë 23.3.2023, “Rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare, në lidhje me kontaminantët në ushqim”, edhe kur nuk ka ndryshime me planin e vitit të kaluar;

b) Në rastin kur një plan parashikon që kontrollin zyrtar të kombinimeve të caktuara të kontaminantëve ose të grupeve të kontaminantëve dhe grupeve të produkteve nuk janë kryer çdo vit, por që i përket një periudhe të caktuar të vitit, paraqitet një argumentim; dhe

c) Informacione mbi autoritetin ose autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e planeve.

Neni 7

#### Prezantimi dhe vlerësim i planeve të kontrollit

Brenda datës 31 mars të çdo viti Shqipëria, në rrugë elektronike, i paraqet Komisionit Evropian planet e kontrollit, sipas kërkesave të nenit 3 që i përket vitit në vazhdim.

Shqipëria mban parasysh komentet e Komisionit, në zbatimin e planeve përkatëse të kontrollit dhe në hartimin e planeve të ardhshme të kontrollit.

Shqipëria argumenton pozicionin e saj, atëherë ku vendos të mos përditësojë planet e kontrollit mbi bazën e komenteve të bëra nga Komisioni Evropian.

Neni 8

Deri më 30 qershor, Shqipëria do t'i transmetojë Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore (EFSA) të gjitha të dhënat e mbledhura sipas planeve të kontrollit të përmendura në nenin 3.

### ANEKSI I

#### FREKUENCAT MINIMALE E KONTROLLIT PËR PLANIN E KONTROLLIT PËR USHQIMET E VENDOSURA NË TREG

##### 1. Ushqimet me origjinë shtazore

a) Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit gjatë hartimit të planit të kontrollit të kontaminantëve respekton frekuencat minimale të kontrollit, sipas planit të kontrollit për ushqimet e vendosura në treg të specifikuar më poshtë:

|                                                                                                 | Frekuenca e kontrollit                           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| Mishi i gjedhit i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme nga njerëzit)             | Minimumi 0,02% i numrit të kafshëve të therura.  |
| Mishi i dheneve dhe i dhive i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumueshme nga njerëzit) | Minimumi 0,004% i numrit të kafshëve të therura. |



|                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Mishi i derrit i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumushme nga njerëzit)                                     | Minimumi 0,003% i numrit të kafshëve të therura.                                                                                                                                                                                                                                             |
| Mishi i njëthundrakëve i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumushme nga njerëzit)                             | Numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                                             |
| Mishi i shpendëve i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumushme nga njerëzit)                                  | Për secilën kategori të shpendëve të marrë në konsideratë (pulat për prodhimin e mishit, pulat në fund të ciklit të prodhimit të vezëve, gjela deti, shpend të tjera) minimumi 1 kampion për çdo 3000 tonë peshe e prodhimit vjetor (peshe e therur).                                        |
| Mishi i kafshëve të tjera të tokës të mbarështuara i papërpunuar (përfshirë të brendshmet e konsumushme nga njerëzit) | Numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                                             |
| Qumështi i freskët i lopës                                                                                            | Minimumi 1 kampion për çdo 110000 tonë të prodhimit vjetor të qumështit.                                                                                                                                                                                                                     |
| Qumështi i freskët i dhenve dhe i dhive                                                                               | Numri i kampioneve përcaktohet nga secili shtet anëtar në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                     |
| Vezë pule dhe vezë të tjera të freskëta                                                                               | Minimumi 1 kampion për çdo 3700 ton të prodhimit vjetor të vezëve.                                                                                                                                                                                                                           |
| Mjalti                                                                                                                | Minimumi 1 kampion për çdo 1300 tonë të prodhimit vjetor.                                                                                                                                                                                                                                    |
| Produktet e peshkut të patransformuara (me përjashtim të krustaceve)                                                  | Minimumi 1 kampion për çdo 700 tonë të prodhimit vjetor të akuakulturës për 60000 tonët e parë të prodhimit dhe më pas 1 kampion për çdo 2000 tonë shtesë. Për produktet e peshkut të egër, numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura. |
| Krustacet dhe molusqet bivalvore                                                                                      | Numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                                             |
| Dhjami dhe yndyrat shtazore dhe detare                                                                                | Numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                                             |
| Produktet të përpunuara me origjinë shtazore                                                                          | Numri i kampioneve përcaktohet në funksion të nivelit të prodhimit dhe të problemeve të gjetura.                                                                                                                                                                                             |

b) Autoriteti kompetent për kryerjen e kontrolleve zyrtare kryen çdo vit kontrolle mbi “metalet” në minimum 10% të mostrave të marra për çdo grup produktesh, në përputhje me tabelën e këtij aneksi, me përjashtim të grupeve të produkteve “krustace dhe molusqe bivalvore”, “dhjami dhe yndyrat shtazore dhe detare” dhe “produktet e përpunuara me origjinë shtazore”.

c) Autoriteti kompetent për kryerjen e kontrolleve zyrtare kryen çdo vit kontrolle që u përkasin mykotoksinave minimumi 10% i kampioneve të marra për grupin e produkteve “qumështi i freskët i lopës” dhe “qumështi i freskët i dhenve dhe i dhive”, në përputhje me përshkrimet e tabelës së këtij aneksi.

d) Brenda grupit të produkteve “mishi i papërpunuar i gjedhit, deles dhe dhisë (përfshirë të brendshmet e konsumueshme nga njerëzit)”, mostrat do të merren nga të gjitha llojet, duke marrë parasysh vëllimin e tyre relativ të prodhimit.

e) Brenda grupit të produkteve “mishi i papërpunuar i shpendëve (përfshirë të brendshmet e konsumueshme nga njerëzit)”, mostrat do të

merren nga të gjitha llojet, duke marrë parasysh vëllimin e tyre relativ të prodhimit

f) Për përcaktimin e numrit të mostrave për produktet e peshkut dhe molusqet bivalve, merren në konsideratë aspektet gjeografike, vëllimet e uljes/prodhimit dhe modellet specifike të kontaminimit në zonat nga të cilat janë mbledhur.

g) Për llogaritjen e frekuencave minimale të kontrollit përdoren të dhënat më të fundit të disponueshme të prodhimit, të paktën nga viti i mëparshëm ose maksimumi nga viti i parafundit.

h) Në rast se frekuenca e kontrollit të llogaritur në përputhje me këtë aneks do të përfaqësonte më pak se pesë mostra për vit, kampionimi mund të kryhet një herë në dy vjet.

i) Në rast se, brenda një periudhe trevjeçare, nuk arrihet prodhimi që korrespondon me një minimum prej një kampioni, do të analizohet një minimum prej dy mostrash një herë në tre vjet.

j) Mostrat e marra për qëllime të planeve të tjera të kontrollit të rëndësishme për analizën e kontaminantëve (p.sh. mbi substancat farmakologjikisht aktive dhe mbetjet e tyre, mbi mbetjet e pesticideve), mund të përdoren,



gjithashtu, për kontrollet mbi kontaminantët, me kusht që të respektohen kërkesat në lidhje me kontrollet mbi kontaminantët.

## 2. Ushqimet me origjinë jo shtazore<sup>4</sup>

Autoriteti kompetent për kryerjen e kontrolleve zyrtare do të marrë të paktën 100 deri në 2 000 mostra në vit, në varësi të madhësisë së popullsisë së tyre. Megjithatë, kur është e nevojshme, për shkak të rrezikut do të merren më shumë mostra për të siguruar që kontrollet të mbeten efektive.

Marrja e mostrave duhet të jetë përfaqësuese për kontaminantë të ndryshëm, të cilët mund të jenë të pranishëm në produkte të ndryshme në treg, duke marrë parasysh gjithashtu modelet e ndryshme të kontaminantëve në produktet me origjinë nga rajone të ndryshme, numrat dhe madhësitë e ndryshme të operatorëve të biznesit ushqimor.

### ANEKSI II

#### FREKUENCA MINIMALE E KONTROLLIT NË PLANIN E KONTROLLIT PËR USHQIMET ME ORIGJINE SHTAZORE QË IMPORTOHEN

Autoriteti kompetent për kryerjen e kontrolleve zyrtare respekton frekuencën minimale të kontrollit të përcaktuar në tabelën më poshtë.

|                                                                                                                                                                                                                         | Frekuenca e kontrollit                |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Gjedhi (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi)                                                         | Minimumi 1% e ngarkesave të importit  |
| Dhen dhe dhi (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi)                                                   | Minimumi 1% të ngarkesave të importit |
| Derra (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi)                                                          | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Njëthundrakë (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi)                                                   | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Shpendë (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi)                                                        | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Mishi i kafshëve të tjera të kafshëve të tokës të mbarështuara (përfshirë mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë mekanikisht, të brendshmet e konsumushme nga njerëzit, produktet e mishit dhe produktet me bazë mishi) | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Qumështi (përfshirë qumështin e freskët, produktet e qumështit, kulloshtren dhe produktet me bazë kulloshtren e të gjitha llojeve të kafshëve)                                                                          | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Vezë (përfshirë vezët dhe produktet e vezëve të të gjitha llojeve të shpendëve)                                                                                                                                         | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Mjalti (përfshirë mjaltin dhe produktet e tjera të produkteve të apikulturës)                                                                                                                                           | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Produktet e peshkimit të papërpunuara me përjashtim të krustaceve                                                                                                                                                       | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Krustacet dhe molusqet bivalvorë (përfshirë muskulin dhe produktet me bazë muskul)                                                                                                                                      | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |
| Dhjami dhe vajra shtazore dhe detare                                                                                                                                                                                    | Minimumi 1% i ngarkesave të importit  |

<sup>4</sup> Për qëllime të këtij udhëzimi, kriteret përkatëse për ushqimin me origjinë joshtazore do të zbatohen për produktet e përbëra.

**Dispozitat shitesë:**

1. Frekuenca e kontrollit për produktet e tjera të përpunuara me origjinë shtazore, si xhelatina dhe kolagjeni, do të përcaktohet duke marrë parasysh numrin e ngarkesave të importuara dhe problematikat e identifikuara.

2. Për llogaritjen e frekuencave minimale të kontrollit të renditura në këtë aneks, përdoren të dhënat më të fundit të numrit të ngarkesave që hyjnë nëpërmjet pikave të inspektimit kufitar, të paktën nga ato të mëparshme ose maksimumi nga viti i parafundit.

3. Në rast se numri i ngarkesave të ushqimit të destinuar për t'u vendosur në treg është më i ulët se numri i ngarkesave që korrespondojnë me një kampion, atëherë mund të kryejnë kampionimin një herë në dy ose tre vjet. Në rast se numri i ngarkesave të importuara gjatë një periudhe trevjeçare është më i ulët se numri i ngarkesave që korrespondojnë me një kampion, merret të paktën një mostër një herë në tre vjet.

4. Mostrat e marra për qëllime të planeve të tjera kontrolli të rëndësishme për analizën e kontaminantëve (p.sh. mbi substancat farmakologjike aktive dhe mbetje të tyre, mbi mbetje të pesticideve) mund të përdoren, gjithashtu, për kontrollet mbi kontaminantët, me kusht që të respektohen kërkesat në lidhje me kontrollet ndaj kontaminantëve.

**UDHËZIM****Nr. 8, datë 23.3.2023**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME  
NË UDHËZIMIN NR. 11, DATË 10.5.2021,  
“PËR NIVELIN MAKSIMAL TË  
MBETJEVE TË PESTICIDEVE NË  
FRUTA, PERIME, FARA TË FRESKËTA  
DHE/OSE TË PËRPUNUARA”<sup>5</sup>**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4 të Kushtetutës, nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 11, datë 10.5.2021, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si vijon:

1. Në titull, në fund të titullit shtohet togfjalëshi “si dhe në produktet ushqimore me origjinë nga kafshët”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me përmbajtje, si vijon:

“1.1 Niveli maksimal i mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore me origjinë nga kafshët është sipas shtojcës së dytë të këtij udhëzimi. Pas shtojcës shtohet “shtojca 2”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

4. Udhëzimi nr. 5, datë 7.9.2009, “Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore me origjinë nga kafshët”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
Frida Krifca**

<sup>5</sup> Ky udhëzim përaftron rregulloren (KE) nr. 396/2005, datë 23 shkurt 2005, “Mbi nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ose mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë me origjinë bimë dhe shtazore”.



## SHTOJCA 2

## MBETJET E PESTICIDEVE NË PRODUKTET USHQIMORE ME ORIGINË NGA KAFSHËT

## A. Derra

| Produktet dhe kodi sipas nomenklaturës së kombinuar |                                                                                                                                                                    | 101020 dhjam | 101000 (a) derra | 101010 muskul | 101040 veshkë | 101030 mëlçi | 101990 të tjera |
|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------------|---------------|---------------|--------------|-----------------|
| Pesticide Id                                        | Pesticidet                                                                                                                                                         | (mg/kg)      |                  |               |               |              |                 |
| 1                                                   | 1,1-dichloro-2,2-bis(4-ethylphenyl) ethane (F)                                                                                                                     | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 2                                                   | 1,2-dibromoethane (ethylene dibromide) (F)                                                                                                                         |              |                  |               |               |              |                 |
| 3                                                   | 1,2-dichloroethane (ethylene dichloride) (F)                                                                                                                       | 0.1*         | 0.1*             | 0.1*          | 0.1*          | 0.1*         | 0.1*            |
| 228                                                 | 1,3-Dichloropropene                                                                                                                                                | 0.02*        | 0.02*            | 0.02*         | 0.02*         | 0.02*        | 0.02*           |
| 2350                                                | 1,4-Dimethylnaphthalene                                                                                                                                            |              |                  |               |               |              |                 |
| 229                                                 | 1-Naphthylacetamide dhe 1-naphthylacetic acid (shuma e 1-naphthylacetamide dhe 1-naphthylacetic acid dhe kripërave të tyre, të shprehura si 1-naphthylacetic acid) | 0.06*        | 0.06*            | 0.06*         | 0.06*         | 0.06*        | 0.06*           |
| 4                                                   | 1-methylcyclopropene                                                                                                                                               | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 6                                                   | 2,4,5-T (shuma e 2,4,5-T, kripërave dhe estereve të tyre, të shprehura si 2,4,5-T) (F)                                                                             | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 7                                                   | 2,4-D (shuma e 2,4-D, kripërave të tyre, estereve dhe përbërjeve të tyre, të shprehura si 2,4-D)                                                                   | 0.2          |                  | 0.2           | 5.0           | 5.0          | 5.0             |
| 5                                                   | 2,4-DB (shuma e 2,4-DB, kripërave të tyre, estereve dhe përbërjeve të tyre, të shprehura si 2,4-DB)                                                                | 0.05*        | 0.05*            | 0.05*         | 0.05*         | 0.05*        | 0.05*           |
| 2530                                                | 2,5-dichlorobenzoic acid methylester (shuma e 2,5-dichlorobenzoic acid dhe estereve të tij të shprehura si 2,5-dichlorobenzoic acid methylester)                   | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 2397                                                | 2-amino-4-methoxy-6-(trifluoromethyl)-1,3,5-triazine (AMIT), si rezultat i përdorimit të tritosulfuron (F)                                                         | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 2343                                                | 2-naphthoxyacetic acid                                                                                                                                             | 0.01*        |                  | 0.01*         | 0.01*         | 0.02*        | 0.01*           |
| 2058                                                | 2-phenylphenol (shuma e 2-phenylphenol dhe përbërjeve të tij, të shprehura si 2-phenylphenol) (F)                                                                  | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 2418                                                | 3-decen-2-one                                                                                                                                                      | 0.1*         | 0.1*             | 0.1*          | 0.1*          | 0.1*         | 0.1*            |
| 2605                                                | 6-Benzyladenine                                                                                                                                                    | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 2318                                                | 8-hydroxyquinoline (shuma e 8-hydroxyquinoline dhe kripërave të tyre, të shprehura si 8-hydroxyquinoline)                                                          | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 8                                                   | Abamectin (shuma e avermectin B1a, avermectin B1b dhe delta-8,9 izomer i avermectin B1a, të shprehura si avermectin B1a) (F)                                       | 0.01*        | 0.01*            | 0.01*         | 0.01*         | 0.01*        | 0.01*           |
| 9                                                   | Acephate                                                                                                                                                           | 0.02*        | 0.02*            | 0.02*         | 0.02*         | 0.02*        | 0.02*           |
